



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2023

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës për informacion mbi çështjet e rinisë.

Të Nderuar,

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar Bashkisë Shkodër, më poshtë do gjeni informacionin mbi çështjet e rinisë.

Promovimi dhe nxitja e pjesëmarrjes aktive e të rinjve në aktivitete kulturore, sportive dhe sociale si aktor thelbësor në zhvillimin e territorit, do të arrihet me anë të aktiviteteve të ndryshme kulturore, sportive dhe rinore të parashikuara brenda vitit 2022 duke përmendur: zhvillimin e një jave festival shahu me 70 shahistë të moshave të ndryshme, zhvillimi i maratonës së pavarësisë, zhvillimi i një jave beach volley me pjesëmarrjen e sportistëve amatorë dhe profesionistë, zhvillimin e një aktiviteti ndërkombëtar boksi, motivim dhe mirënjohje për 10 sportistët më të mirë, zhvillimi për herë të parë i kinemasë në ambient të hapur ku të rinjtë do mund të shohin filma të ndryshëm në qendër të qytetit, zhvillimi i festivalit të JAZZ, Karnavalet, Shkodra n’Fest, ZA Fest, zhvillimi i një festivali teatri me shkollat e mesme, mbështetja e vazhdueshme e ekipeve për të rinj si: basketboll, volejball, xhudo, futboll etj. Gjithashtu, brenda këtij kuadri do organizohen edhe 4 aktivitete vullnetarizmi me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve në angazhimin e tyre në nisma në të mirë të komunitetit. Informimi i të rinjve rreth vlerave të trashëgimisë kulturore, gjatë vitit 2022 do arrihet me anë të 6 aktiviteteve informuese dhe promovuese të vlerave të trashëgimisë kulturore në territorin e Bashkisë Shkodër. Njohja dhe promovimi i letërsisë tek të rinjtë përmes takimeve dhe njohjes me shkrimtarë të njohur.

Konkretisht në aktivitetet kulturore për rininë është planifikuar shuma prej 9,879,000 lekë, ndërsa në aktivitetet sportive dhe mbështetjen e 14 shoqatave sportive rinore është planifikuar shuma prej 42,197,000 lekë.

Gjithashtu, Bashkia Shkodër në kuadër të promovimit të turizmit dhe vlerave natyrore zhvillon aktivitete të ndryshme ku në fokus është rinia dhe jo vetëm, si: Hapja e Sezonit Turistik Velipojë, Festa e Thethit, Triathlon, Dita e biçikletave, Lojra Popullore Fest, etj.

Bashkia Shkodër bashkëpunon me Universitetin Luigj Gurakuqi në mbështetje të të rinjve, kërkimit shkencor, praktikave profesionale etj.

Informimi dhe promovimi për një komunitet të shëndetshëm, ku targeti kryesor janë të rinjtë. Mbahen takime informuese dhe sensibilizuese organizuara në ditët ndërkombëtare të shëndetit, me synim përmirësimin e shëndetit, cilësisë së jetës dhe parandalimin e sëmundjeve në komunitet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Pranë Bashkisë Shkodër, funksionon Qendra Rinore “Atelie” dhe gjithashtu janë ngritura 12 qendra komunitare “Për Familjen” nga të cilat 7 në qytet dhe 5 në njësi administrative, të cilat përveç shërbimeve të tjera pët komunitetin, ofrojnë dhe shërbime specifike orientimi dhe angazhimi për rininë.

Bashkia Shkodër ndjek “Planit Lokal i Veprimit për Rininë 2020-2023” i cili u bë i mundur falë mbështetjes së plotë të Fondacionit Friedrich Ebert, i cili mbështet zhvillimin e politikave rinore në nivel vendor dhe qendror, në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar.

Puna e zhvilluar në nivel kombëtar për planet e veprimit 2020-2023 ka pasur synim nxitjen e dialogut të strukturuar rini-institucione, në bazë të një metodologjie dhe rrugëtimi të njehsuar, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat aktive të Kongresit Rinor Kombëtar dhe me gjerë, të rinj nga shkollat e mesme dhe universitetet, si dhe me mbështetjen e madhe dhe angazhimin sistematik të Bashkisë Shkodër.

Bashkia Shkodër është duke pregaditur “Strategjinë Lokale Rinore” për vitet në vijim, në bashkëpunim me Qendrën Burimore për Evropën Jug-Lindore (SALTO) për të zhvilluar më tej strategjitë e pushtetit lokal në fushën e rinisë dhe për të integruar një dimension Evropian në qasjen dhe aktivitetet e Bashkisë Shkodër. Aktualisht nuk ka dokumantacion të publikuar në faqen e Bashkisë Shkodër.

Në kuadër të politikave rinore është duke u krijuar i Këshilli Vendor Rinor (KVR), i cili është në proces ngritje në Bashkinë Shkodër. Projekt vendimi për krijimin e Këshillit Rinor Vendor është miratuar nga Këshilli Bashkiak dhe sipas manualit të ngritjes të Këshillit Vendor Rinor të realizuar nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, do bëhet thirja/ nftimi publik për anëtarësimin në Këshillin Vendor të Rinisë.

Aktiviteti i Bashkisë Shkodër drejt fuqizimit të të rinjve nis me ndërtimin e qendrës së parë rinore publike me emrin “Atelie”, pas së cilës qëndron edhe motivimi dhe interesi për këtë aplikim. “Youth Empoëered Sustainable Future - YES Future” u emërua projekti në bashkëpunim me organizatën ACLI IPSIA dhe Bashkinë e Triestes, i cili në vitin 2018 themeloi “Atelie” si bashkëfinancim ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe programit IADSA. “Atelie” është një shërbim publik i Bashkisë Shkodër dedikuar rinisë dhe është pjesë e rrjetit të Qendrave Komunitare “Për Familjen”, nën menaxhimin e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

Bashkia e Shkodrës ka një strukturë të përzier që kontribuon për të rinjtë. Në këtë fushë funksionojnë dy drejtori: Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik e cila mbështet dhe ka në strukturën e saj të brendshme Qendrën Rinore Publike “Atelie” dhe Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sporteve e cila përfshin rininë në aktivitete kryesisht të kulturës dhe sportit. Aktivitetet kryesore, përgjegjësitë dhe koordinimi i delegohen qendrës rinore.

Objektivi kryesor i qendrës rinore mbështetet në fuqizimin dhe promovimin e të rinjve përmes zbatimit të programeve arsimore cilësore dhe gjithëpërfshirëse, punësimit dhe sipërmarrjes, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të rinjve në politikë dhe vendimmarrje (vendore dhe qendrore), art, kulturë, sport dhe mjedis; promovimin e nismave dhe organizatave dhe programeve rinore për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

çështje sociale dhe shëndetësore; të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në promovimin e të rinjve të rajonit tonë.

Në këtë drejtim, Bashkia Shkodër me anë të buxhetit të saj kontribuon në lehtësimin e infrastrukturës dhe mbulon koston e personelit, kostot operative dhe shpenzimet e mirëmbajtjes së hapësirave të dedikuara. Nëpërmjet bashkëpunimit me donatorë dhe OSHC të ndryshme, aktivitetet realizohen me kapacitetin maksimal që ofron qendra rinore e qytetit.

Personi përgjegjës për çështjet e rinisë në Bashkinë Shkodër është koordinatori i Qendrës Rinore “Atelie”. Qendra funksionon edhe nëpërmjet vullnetarëve të cilët së bashku me koordinatorin dhe përgjegjësit e organizatave që operojnë në qendër kanë krijuar edhe një Bord Drejtues.

Bashkia Shkodër po punon në vazhdimësi me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ka partneritet me institucione të ndryshme për krijimin e marrëdhënieve, bashkëpunimit dhe financimit në fushën e rinisë. Disa nga organizatat me të cilat bashkia ka marrëveshje partneriteti të cilat zbatohen në funksion të Qendrës Rinore “Atelie” dhe janë të lokalizuara brenda qendrës duke i dhënë asaj aktivitete të përditshme janë:

“Save the Children” një organizatë lider humanitare për fëmijë dhe së fundmi që ofron mbështetje për të rinjtë në aspektin e aftësive të buta, orientimit dhe këshillimit, ofron kurse pas shkollës deri në moshën 24 vjeç dhe klasa artizanale (hapësira të dhëna në përdorim nga qendra rinore);

“YEA! – Young Entrepreneurs Albania” një organizatë e fokusuar në mbështetjen e sipërmarrësve të rinj në Shqipëri, duke krijuar aktualisht inkubatorin e biznesit në hapësirat e qendrës rinore, zhvillon orët periodike pas shkollës, ndihmon familjet në nevojë me pagesa mujore dhe ofron konkurse periodike për të rinjtë me synimin për të fituar aftësi menaxheriale për bizneset e ardhshme;

“UNICEF” një agjenci e Kombeve të Bashkuara përgjegjëse për ofrimin e ndihmës humanitare dhe zhvillimore për fëmijët në mbarë botën ka ndërtuar në qendrën rinore një laborator të ri TIK të quajtur “BIBLIOTECH”, një mundësi e shkëlqyer për të rinjtë që të punojnë pa pagesë në internet, promovon internetin e sigurt dhe inovacionin në mënyrën se si studiojnë të rinjtë;

“Palladium Group” një kompani ndërkombëtare këshilluese dhe administruese e cila si një marrëveshje partneriteti 2-vjeçar me qendrën rinore, synon viktimat e mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore dhe ofron aktivitete periodike ndërgjegjësuere me të rinjtë.

Disa nga institucionet e tjera vendore që bashkia bashkëpunon në fushën e rinisë janë Teatri i qytetit “Migjeni”, trupa e së cilës prej 10 të rinjsh u krijua fillimisht nga Grupi i Aktrimit të Qendrës Rinore “Atelie”, Qendra Kulturorë “Pjeter Gaci”, e cila kohë pas kohë shfrytëzon sallën e vallëzimit për provat e tyre; Biblioteka e qytetit “Marin Barleti” me të cilët aktualisht po punojnë për krijimin e Grupit të Leximit; Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive “AKPA” dhe Qendra e Formimit Profesional.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile është një një përfaqje mbështetëse nga ana e Bashkisë Shkodër, por edhe një ndërveprim aktiv, në mënyrë që të ketë sa më shumë nisma cilësore nga ana e të rinjve. Për këtë, prioritetet dhe masat janë orientuar drejt mundësive financiare dhe

aktiviteteve konkrete që ndihmojnë organizatat grupimet dhe nismat rinore, në mënyrë që të funksionojnë si duhet dhe të kenë qëndrueshmëri.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin;

KRYETAR

Benet Beci